



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 01/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____ si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____ pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija Kërveshi, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe përmbaruesi privat, z. _____ dhe pas seancës këshillimore, me datën 01.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-01/2022, datë 11.01.2022, si dhe ankesa e palës ankuese z. _____ nga _____ dt 10.01.2022, si të pabazuara.

A R S Y E T I M

Me datën 10.01.2022, pala ankuese z. _____ nga _____ ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____. Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat z. _____ i ka shkaktuar palës ankuese dëm financiar në vlerë prej tregjind e katër dhjetë (340 €) euro. Sipas palës ankuese, ai nuk ka asnjë borxh ndaj Komunës së Artanës, siç pretendohet nga pala kreditore. Megjithatë, përmbaruesi privat z. _____, sipas palës ankuese, në një periudhë prej gjashtë (6) muaj i ka bllokuar llogaritë bankare duke i pamundësuar edhe tërheqjen e të ardhurave nga pensioni i veteranit me çka përmbaruesi privat ka dëmtuar atë financiarisht. Po ashtu, pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat z. _____ pas takimit me palën ankuese nuk ka treguar sjellje profesionale.

Me datën 11.01.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, pas shqyrtimit të çështjes ka paraqitur në Komisionin Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përmbarruesit privat z. _____, si organ përmbarrues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, lidhur me veprimet e ndërmarra në lëndën e lartpërmendur përmbarrimore.

Përmbarruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim thekson se pretendimet për shkelje disiplinore janë të pabazuara. Shton se përmbarrimi është lejuar me urdhrin përmbarrimor P. nr 250/2020 të datës 13.10.2020 mbi bazën e dokumentit të besueshëm-faturave me nr: 00144, 00144 dhe 00146 të cilat pala kreditore i ka bashkangjitur propozimit. Sipas përmbarruesit privat, pala debitore përkatësisht ankuese ka pranuar në mënyrë të rregullt propozimin për përmbarrim dhe urdhrin për përmbarrim me datën 19.10.2020 dhe nuk ka ushtruar mjetin juridik. Rrjedhimisht me datën 27.10.2020, urdhri përmbarrimor ka marr formën e prerë. Meqenëse pala debitore nuk ka përmbushur detyrimin e tij, sipas përmbarruesit privat, me datën 12.07.2021 palës debitore i janë bllokuar llogaritë bankare. Ndërsa me datën 25.11.2021, pala kreditore ka kërkuar ndërprerjen e procedurës përmbarrimore, dhe po të njëjtën datë, organi përmbarrues ka nxjerr konkluzion për lirim të llogarisë bankare të palës debitore kurse me datën 26.11.2021, konkluzion për përfundimin e procedurës përfundimtare. Rrjedhimisht, përmbarruesi privat thekson se ka vepruar në pajtim me dispozitat e procedurës përmbarrimore dhe kërkon refuzimin e ankesës ndaj tij si të pabazuar.

Me datën 01.03.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, znj. Burbuqe Spahija Kërveshi dhe përmbarruesi privat, z.

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit Përfundimtar duke theksuar se mbetet pranë të njëjtit. Po ashtu, përmbarruesi privat ka ngelur pranë përgjigjes në ankesë,

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbarruesi privat z. _____ nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se pala ankuese pretendon se përmbarruesi privat z. _____ ka zbatuar përmbarrimin edhe pse ai nuk ka ndonjë detyrim ndaj _____, se i ka bllokuar atij llogarinë bankare përfshirë mjetet nga pensioni i veteranit si dhe ka pasur sjellje jo profesionale ndaj tij. Për sa i përket pretendimit se pala ankuese nuk ka obligime ndaj palës kreditore përkatësisht _____, Komisioni Disiplinor është i kufizuar që të ofrojë ndonjë analizë në mungesë të kompetencës së tij. Mandati i Komisionit Disiplinor lidhet ekskluzivisht me përgjegjësinë disiplinore të përmbarruesve privat ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me pretendimet lidhur me obligimet mes palëve duhet adresuar në gjykatën kompetente përmes shfrytëzimit të mjetit juridik në dispozicion të palëve. Siç është theksuar edhe në vendime tjera, Komisioni Disiplinor nuk është organ instancional dhe zëvendësues i organeve gjyqësore ku palët mund të

adresojnë pretendimet e tyre për çështjet të cilat kompetenca bie tek gjykatat. Me fjalë tjera, roli i Komisionit Disiplinor, në thelb, është i kufizuar në shkeljet disiplinore. Kur pala e pakënaqur nuk pajtohet me vendimin e caktuar, në këtë rast urdhrin përmbartimor, pala duhet t'i adresohet gjykatës kompetente. Në rastin në fjalë, urdhri përmbartimor P. nr 250/2020 i datës 13.10.2020 përmban këshillën juridike për mjetin juridik në dispozicion të palëve. Rrjedhimisht, edhe këtu, pala ankuese kishte të drejtë të sfidon urdhrin përmbartimor në gjykatën kompetente duke ndjekur procedurat ligjore.

Ndërsa sa i përket bllokimit të llogarisë bankare dhe tërheqjes së mjeteve nga përmbartuesi privat, Komisioni Disiplinor gjen se, bazuar në shkresat e lëndës, përmbartuesi privat z. [] kishte bllokuar llogarinë 12.07.2021, derisa urdhri për përmbartim kishte formën e prerë nga data 27.10.2020. Thënë ndryshe, përmbartuesi privat z. [] i kishte dhënë kohë të mjaftueshme palës ankuese që të përmbush detyrimin e tij në mënyrë vullnetare për të shmangur shpenzimet procedurale. Në anën tjetër, përmbartuesi privat, siç vërtetohet edhe me konkluzionin P. nr 250/20 të datës 19.07.2021 për transferimin e mjeteve, kishte urdhëruar bartjen e mjeteve në llogarinë e përmbartuesit privat të shumës prej: ½ (një të dytën) për çdo muaj nga pensioni i debitorit deri në përmbushjen e detyrimit dhe shpenzimeve të procedurës përmbartimore, ndërsa shumë të tjetër kishte urdhëruar bankën t'ia liron palës debitore. Kjo është në pajtueshmëri me dispozitën e nenit 112 par 1 lidhur me nenin 152 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore Nr 04/L-139 i cili përcakton që *“përmbartimi në të ardhura personale, për shpërblimin në vend të pagës dhe për pensionin, mund të caktohet dhe zbatohet deri në gjysmën e lartësisë së tyre. Shuma që sekuestrohet do të kufizohet në pjesën që tejkalon shumën e ndihmës më të lartë sociale që paguhet brenda territorit ku debitori ka vendbanimin.”* Pasi që përfaqësuesi i palës kreditore kishte tërhequr propozimin përkatësisht kishte kërkuar ndalimin përmbartimit me datën 25.11.2021, përmbartuesi privat z. [] po të njëjtën datë kishte nxjerrë konkluzion për lirim të llogarisë bankare dhe me datën 26.11.2021 kishte nxjerrë konkluzion për përfundimin e procedurës përmbartimore. Rrjedhimisht, komisioni disiplinor gjen se pretendimet e këtu palës ankuese për shkelje disiplinore janë të pabazuara.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 01/2022, datë 01.03.2022

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

The following information was obtained from the records of the
Department of Health and Human Services, Office of the
Inspector General, on or about 10/1/2010. The information was
obtained from the records of the Department of Health and Human
Services, Office of the Inspector General, on or about 10/1/2010.

The following information was obtained from the records of the
Department of Health and Human Services, Office of the
Inspector General, on or about 10/1/2010. The information was
obtained from the records of the Department of Health and Human
Services, Office of the Inspector General, on or about 10/1/2010.



Department of Health and Human Services
Office of the Inspector General
10/1/2010